



# STIKK

SHOQATA PËR TEKNOLOGJI TË INFORMACIONIT  
DHE TË KOMUNIKIMIT TË KOSOVËS

KOSOVO ASSOCIATION OF INFORMATION  
AND COMMUNICATION TECHNOLOGY

# Standardet në Sektorin e TIK-ut: **PENGESË APO PËRPARËSI?**

## RAPORT STUDIMOR

Prishtinë, Janar 2012

Raport i përgatitur nga:



Mr. Kushtrim SHAIPI

Ms. Nerilë LATIFI

[www.iqconsulting.biz](http://www.iqconsulting.biz)

Përkthyer në gjuhën shqipe nga:

A&A Consulting

Prishtinë

Janar, 2012

Ky studim u kontraktua nga STIKK-u (Shoqata për Teknologji të Informacionit dhe të Komunikimit të Kosovës). Ai përmban një vështrim mbi zhvillimin e sektorit të TIK-ut në Kosovë si dhe një analizë të plotë për standardizimin në këtë sektor. Këndvështrimet e shprehura në këtë dokument janë të autorëve dhe nuk reflektojnë detyrimisht këndvështrimet e STIKK-ut.

# PËRMBAJTJA:

PËRMBAJTJA .....	3
PËRMBLEDHJA EKZEKUTIVE .....	4
1. HYRJE .....	5
1.1. Rregullimi ligjor .....	5
1.2. Gjendja momentale në sektorin e TIK-ut .....	6
2. NEVOJA PËR STANDARDIZIM .....	8
2.1. Përfitimet nga standardizimi i TIK-ut .....	8
2.2. Vlerat dhe llojet e ndryshme të certifikatave të TIK-ut.....	9
2.3. Pengesat dhe problemet e mundshme .....	10
2.4. Procesi i standardizimit dhe masat që duhet të merren .....	11
2.5. Integrimi në BE dhe standardizimi në Fushën e TIK-ut .....	12
3. PËRFUNDIMET E NXJERRA DHE REKOMANDIMET .....	12
3.1. Rekomandimet për qeverinë .....	12
3.2. Rekomandimet për STIKK-un .....	13
3.3. Rekomandimet për bashkësinë e donatorëve .....	13
REFERENCAT .....	14
SHTOJCA 1: INFRASTRUKTURA LIGJORE PËR TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE .....	15

## PËRMBLEDHJE E PËRGJITHSHME

Ky studim është kontraktuar nga STIKK-u me qëllim të identifikimit të qasjeve më të përshtatshme dhe të analizimit të aspekteve pozitive dhe negative për standardizim në sektorin e TIK-ut. Si i tillë, ai sjell një vështrim të situatës në sektorin e TIK-ut që duhet të rregullohet, opsionet për veprim, si dhe një sërë faktesh në favor të standardizimit të një shkalle më të lartë në sektorin e TIK-ut. Ky punim poashtu lokalizon me saktësi problemet dhe pengesat e mundshme në procesin e standardizimit si dhe mënyrën e duhur për t'i zvogëluar ato rreziqe. Përfitimet nga standardizimi vijnë si për zhvillimin e sektorit ashtu edhe për konsumuesit e blerësit. Nga ngritja e standardeve të cilësisë në sektorin e TIK-ut përfitojnë kompanitë pasi që ua mundëson atyre që të shesin shërbimet e tyre më lehtë edhe jashtë Kosovës, qeveria dhe blerësit e tjerë institucional do të fitonin një vlerë më të madhe materiale falë kualitetit të ngritur, poashtu rritet konkurrenca në treg, ndërsa mundësia të punësimin e individëve të pajisur me certifikata ndërkombëtare përmirësohet automatikisht.

Sektorin e TIK-ut në Kosovë karakterizohet nga kompani përgjithësisht të vogla që kanë deri 20 punëtorë, tek të cilat përkundër rritjes dhe zhvillimit të vazhdueshëm, ekziston mundësia të përballen me vështirësi në përballimin e vlerës së lartë monetare të certifikatave dhe standardeve të njohura ndërkombëtarisht. Karshi zhvillimit të politikave dhe ndryshimeve, qeveria dhe palët e tjera të interesuara në sektorin e TIK-ut duhet të asistojnë akterët e tregut që me sukses dhe sa më lehtë ta kalojnë procesin e standardizimit. Përkrahja mund të jetë përmes ndihmesës teknike, subvencioneve për projekte të certifikimit, apo lirimeve nga taksa për kompanitë që bëjnë certifikimin e standardeve të tyre cilësore.

Duke qenë se e ardhmja evropiane e Kosovës veçse është konfirmuar edhe nga vullneti i popullit edhe nga elitat e tij politike për t'u anëtarësuar në BE-së dhe poashtu duke pasur parasysh vullnetin e liderëve të BE-së për ta pranuar Kosovën në mesin e vet, standardizimi është më shumë një çështje që lidhet me kohën, sesa me pyetjen se a do të ndodhë apo jo. Sektorin e TIK-ut në BE është i rregulluar nga Komisioni Evropian si pjesë e përpjekjeve të këtij institucioni për ta rregulluar Tregun e Përbashkët të Bashkimit Evropian. Dhe për këtë qëllim, direktivat e obligueshme dhe aktet e tjera detyruese janë nxjerrë vazhdimisht, duke llogaritur kornizën rregullative mbi standardet për industrinë e TIK-ut. Sa më herët që ky proces të fillojë në Kosovë do të jetë më mirë pasi që do t'u jap kompanive të TIK-ut më shumë kohë për ta menaxhuar procesin e ndryshimit më mirë dhe më lehtë.

Në procesin e standardizimit duhet të angazhohen të gjitha kompanitë e interesuara relevante duke përfshirë këtu edhe agjencitë e qeverisë që do ta rregullonin dhe monitoronin sektorin, STIKK-un si asociacionin sektorial, si dhe kompanitë private të TIK-ut veprimtaritë e së cilave do të duhej të përshtateshin. Me aplikimin e qasjes së tillë gjithëpërfshirëse për zhvillim të politikave, gjasa për të vendosur kornizën më të përshtatshme për standardizim rritet dukshëm. Procesin poashtu duhet të shikojë kah kërkesat dhe standardet e BE-së në sektorin e TIK-ut, pasi që edhe synimi kryesor është përafrimi me politikat e BE-së, gjë e cila do të siguronte që politikat e Kosovës të jenë në përputhje me ato të përshkruara nga *acquis communautaire*<sup>1</sup>.

Ndihma teknike dhe përkrahja financiare nga bashkësia e donatorëve që janë momentalisht aktiv në Kosovë sipas të gjitha gjasave do të nevojitet për të përkrahur procesin e standardizimit. Në mungesë të një përkrahjeje të tillë, kompanitë më të vogla perceptojnë standardizimin si një pengesë ndaj rritjes dhe zhvillimit. Në anën tjetër, po që se bashkësia e donatorëve përkrah procesin e standardizimit, kjo gjë do të kontribuonte drejtpërsëdrejti në zhvillimin dhe konsolidimin e sektorit të TIK-ut dhe si rrjedhojë do të kontribuonte në zhvillimin e tërësishtëm ekonomik të Kosovës.

<sup>1</sup> Term në gjuhën frënge. Nënkupton legjisllacionin e grumbulluar, aktet ligjore dhe vendimet gjyqësore, të cilat përbëjnë boshtin ligjor të Bashkimit Evropian.

# 1. HYRJE

Prosperiteti i ekonomisë digjitale është një komponentë kyçe e ekonomisë botërore në lulëzim dhe një nga prioritetet për Evropën të shprehur nga strategjia e Agjendës Digjitale të saj, përballë një ekonomie të lulëzuar digjitale deri në 2020-ën. Agjenda Digjitale përbëhet nga politikat dhe veprimet e nevojshme për t'u kryer në mënyrë që të përfitohen të gjitha të mirat nga Teknologjitë e Informacionit dhe Komunikimeve (TIK). Konkretisht, si pjesë e saj, janë ndërmarrë hapa të shumtë për të përmirësuar procedurat standarde në mënyrë që pajisjet e reja të teknologjisë së informacionit (TI-së), aplikacionet, mjetet për ruajtjen e të dhënave dhe shërbimet të ndër-veprojnë në të njëjtën mënyrë gjithkund. Si një anëtar aspirues i Bashkimit Evropian (BE-së), aktualisht në tranzicion të ekonomisë dhe shoqërisë së vet, Kosova do të duhej të tregojë konsideratë më të madhe për masat e standardizimit të TIK-ut, por edhe për koston e mundshme dhe të mirat e saj.

Duke qenë se Kosova ka konfirmuar qëllimin e saj t'i bashkohet Bashkimit Evropian, standardizimi i TIK-ut është i pashmangshëm dhe është vetëm çështje se si dhe kur e jo se a do të ndodhë. Sa më herët që të fillojë standardizimi do të ketë më shumë kohë për të përfunduar procesin (në pjesën e kompanive). Standardizimi i proceseve vënia e një minimumi të lartë të standardeve cilësore për kompanitë e TIK-ut, mund të dëshmojë të jetë një stimul për rritjen dhe zgjerimin e tërë sektorit. Sidoqoftë, po që se nuk zbatohet si duhet, i tërë sektori mund të vuaj shumë nga masat e reja të detyrueshme. Ky punim opinionit përmbledh praktikatat e mira të shteteve tjera dhe hapat e nevojshëm për shkallë më të madhe të standardizimit në Kosovë. Ai ofron faktet që janë në favor dhe ato që janë kundër standardizimit të proceseve dhe produkteve në sektorin e TIK-ut, duke dhënë një vështrim të hollësishëm të efektit të një standardizimi të tillë të mundshëm.

## 1.1. Rregullimi ligjor

Ndonëse e ndodhur në mes të procesit të shtet-ndërtimit, Kosova ka vendosur themelet e juridiksionit dhe ka kaluar një numër të madh të ligjeve gjatë viteve të kaluara. Megjithatë, duke qenë se ka pasur një numër të madh të problemeve dhe prioriteteve të cilat është dashur të adresohen, radhitja e prioriteteve ka qenë një detyrë shumë e vështirë si për iniciatorët e legjisllacionit ashtu edhe për parlamentin si trup legjisllativ. Në një rregullim të tillë, rregulimeve sektoriale të TIK-ut u është dhënë një prioritet mjaft i ulët në agjendat e ligj-bërësve dhe në këtë mënyrë lënë vendin me politika të pakta që rregullojnë këtë sektor. Edhe pse kanë kaluar afro katër vite ligjvënies (pas shpalljes së pavarësisë), ende hasen zbrazëtira të shumta në sektorë të ndryshëm të cilat duhet të plotësohen. Në këtë kontekst, rruga drejt standardizimit është e trasuar me disa ligje ekzistuese në Kosovë:

Ligji mbi dizajnin industrial, sipas së cilit e drejta e dizajnit industrial është një e drejtë e pronësisë intelektuale që mbron dizajnin vizuel të objekteve që nuk janë tërësisht praktike. Një dizajn industrial përbëhet nga krijimi i formës, aranzhimi apo kompozimi i modelit ose ngjyrës, apo kombinimi i të dyjave duke mbajtur vlerë estetike. Një dizajn industrial mund të jetë një model dy apo tredimensional i përdorur për të prodhuar një produkt, mall industrial apo artizanat. Ligji ofron kërkesat dhe procedurat për regjistrimin e dizajnit industrial dhe të bashkësisë, si dhe të drejtat që burojnë nga ky ligj<sup>2</sup>.

Ligji mbi markat tregtare, sipas së cilit marka tregtare është një shenjë dalluese apo një tregues i përdorur nga një individ, organizatë biznesore apo një entitet tjetër ligjor për të identifikuar produktet apo shërbimet ndaj konsumuesve me të cilat marka tregtare paraqitet filluese nga një burim unik dhe për t'i dalluar produktet apo shërbimet e tyre nga ato të entiteteve të tjera.<sup>3</sup>

2 Ligji për Dizajnin Industrial <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,744>

3 Ligji për Markat Tregtare <http://www.assembly-kosova.org/?cid=2,191,190>

Një markë tregtare mund të përcaktohet nga simbolet në vijim:

- ™ (për një markë tregtare të paregjistruar që është një markë e përdorur për t'u promovuar apo markë e mallrave)
- SM (për një markë shërbyese të paregjistruar që është një markë e përdorur për t'u promovuar apo markë e shërbimeve)
- ® (për një markë të regjistruar tregtare)

Zakonisht marka tregtare është një emër, fjalë, frazë, logo, simbol, dizajn, pamje (imazh) apo një kombinim i këtyre elementeve. Ligji mbi markat tregtare përcakton kërkesat dhe procedurat e regjistrimit të markave tregtare dhe të drejtat që rrjedhin nga regjistrimi si dhe implementimin e këtyre të drejtave.

Ligji mbi patentat, sipas të cilit, patenta është një formë e pronësisë intelektuale. Ajo përbëhet nga një grup i të drejtave ekskluzive të dhëna nga një shtet sovran për një shpikës (zbulues) apo një përfitues të tyre për një periudhë të kufizuar kohore në shkëmbim të deklaramit publik të një zbulimi (shpikjeje).

Zakonisht, një aplikacion për patentë duhet të plotësojë një apo më shumë kërkesa që e definojnë zbulimin, si inovacion dhe jo-spikatshmëri. E drejta ekskluzive e dhënë ndaj një patentë-mbajtësi në shumicën e vendeve është e drejta për t'i parandaluar të tjerët nga ndreqja, përdorimi, shitja apo shpërndarja pa leje e zbulimit të patentuar.

## 1.2. Gjendja momentale në sektorin e TIK-ut

Bazuar në një hulumtim mbi ofertën dhe kërkesën të bërë në vitin 2010, 'TIK-u në Kosovë- Një sektor i dekoduar', i cili ishte porositur nga Programi për Ndërmarrje Private në Kosovë (PNPK- angl. KPEP), sektori i TIK-ut është i përbërë nga kompani relativisht të reja, pasi që shumica e tyre janë inkorporuar pas konfliktit të armatosur të vitit 1999. Një prej karakteristikave kyçe e TIK në Kosovë është përbërja e sektorit nga kompani të vogla me më pak se 20 punëtorë, prej të cilëve shumica janë meshkuj. Kompanitë më të mëdha gjithashtu përbëhen nga numra më të mëdhenj të punëtorëve femra, dhe stabiliteti i përgjithshëm i fuqisë punëtore të TIK-ut është mjaft i lartë me një mesatare prej 2 deri në 6 vjet pune për punëtorë që punojnë në një kompani.

Pjesa më e madhe e shitjeve në sektorin e TIK-ut përbëhet nga shitjet harduerike si komponentë kryesore, ndërsa softueri, shërbimet dhe konsultimet kontribuojnë dukshëm më pak në totalin e shitjes në këtë sektor. Baza e klientëve përbëhet nga klientë individual, klient biznesi dhe të qeverisë, ku shpenzimet e qeverisë numërojnë pjesën më të madhe të të ardhurave nga shitjet, por në një numër shumë të koncentruar të kompanive.

62 përqind e kompanive të TIK-ut kanë raportuar që importojnë mallra për shitje me pakicë, përderisa eksportet e tyre janë minimale dhe potenciali për rritje shihet kryesisht në tregun e brendshëm të Kosovës dhe në disa raste në perspektivën e rritjes mund të shkojë deri në dy shtetet fqinje Shqipëri dhe Maqedoni. Qarkullimi mesatar vjetor i kompanive në këtë sektor është 250,000 Euro, me një numër në rritje të kompanive që raportojnë qarkullime në miliona Euro.

Po i njëjti hulumtim zbulon se kërkesat më të mëdha përbrenda sektorit të TIK-ut janë për certifikime dhe trajnime të njohura ndërkombëtarisht, ku më i kërkuari është certifikimi me ISO-s. Shumica e kompanive që janë analizuar pohojnë se kanë nevojë për trajnim mbi aftësi e "buta" për stafin tyre dhe një numër më i vogël është raportuar të ketë nevojë për trajnime teknike për punëtorët e vet. Me qëllim që sektori të rritet dhe zhvillohet, instrumentet më të kërkuara të kompanive janë trajnimet dhe ekspertiza ndërkombëtare. Të dhënat e ofruara në këtë hulumtim dhe në studime të tjera të sektorit ofrojnë një dëshmi të qartë për nevojën e standardizimit në shkallë më të lartë në sektor, çka do të ndikonte tek zhvillimi sektorial në shumë aspekte.

## Të Drejtat e Pronësisë Intelektuale (DPI) në Kosovë

Në bazë të strategjisë së qeverisë së Kosovës mbi të drejtat e pronësisë intelektuale (DPI- angl. IPR) 2010-2014, nocioni i DPI-së u referohet krijimeve të mendjes: zbulimeve, punimeve letrare dhe artistike, simboleve, emrave, imazheve dhe dizajneve të përdorura në tregti. Mbajtësit e të drejtave mund t'ua ndalojnë të tjerëve të përdorin punimet e tyre pa autorizim paraprak apo mund të përfitojnë nga lejimi i përdorimit të punimeve të tyre në shkëmbim të kompensimit për përpjekjet dhe investimet e tyre gjatë tërë krijimit. Pronësia intelektuale është e ndarë në dy degë, e ato janë 'pronësia industriale' dhe 'e drejta e autorit'.

Pronësia industriale përfshin të drejtat që lidhen me patentat, dizajnët industrial, markat tregtare dhe markat e shërbimeve, indikacionet gjeografike, shumëllojshmëritë e bimës së re, topografitë e qarqeve të integruara dhe mbrojtja nga konkurrenca jo e drejtë.

E drejta e autorit lidhet me krijimet artistike të intelektit njerëzor, romanet, poezitë, kompozimet muzikore, skulpturat, pikturat, vizatimet, punimet kinematografike, arkitektura, koreografia, fotografia dhe të ngjashme. Kjo degë e pronësisë intelektuale gjithashtu përfshinë të drejtat që definojnë si të drejta që lidhen me të drejtat e autorit të artistëve performues (këngëtarë, muzicent të tjerë, valltarë, aktorë dhe të tjerët që performojnë punime); producentëve të fonogrameve, producentëve të filmave dhe organizatave transmetuese.

Hulumtimi i autorizuar nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë i bërë në vitin 2009 mbi rëndësinë e të drejtave të pronësisë intelektuale për bashkësinë e biznesit në Kosovë zbuloi se implementimi i DPI-së në Kosovë është i mangët për shkak të mungesës së kapaciteteve administrative në gjykatën ekonomike të Kosovës. Është me rëndësi të theksohet se grupet më të prekura nga abuzimi i DPI-së janë markat tregtare ndërkombëtare, markat e të cilave përdoren nga prodhuesit falsifikues për produkte të imituara të cilat janë të importuara apo prodhuara në Kosovë; gjithashtu edhe artistët dhe muzicentët kosovar, të cilët shpesh kanë shprehur publikisht pakënaqësinë tyre me problemet e piraterisë në Kosovë. Sidoqoftë, që nga viti 2009, kur është bërë studimi, ka pasur përmirësime të konsiderueshme që janë bërë në forcimin dhe menaxhimin e DPI-së.

## 2. NEVOJA PËR STANDARDIZIM

Ekonomia botërore është në lëvizje të vazhdueshme drejt shkallës më të lartë të operacioneve të bazuara në informacion. Mbajtja e ritmit me këto zhvillime ekonomike kërkon një vendimmarrjen të kujdesshme, pasi që kjo gjë është kyçe për konkurrencë dhe sukses në biznes. Duke u bazuar në këto prirje dhe arsyeshmëri të tyre, sistemet që shfrytëzohen për t'u qasur në informacion dhe për ta shpërndarë atë, së bashku me teknologjitë e tyre shtytëse, janë në qendër të vëmendjes si për na shqetësimet e tregtarëve ashtu edhe në rrafshin e rregullimit të sektorit.

Për më shumë, aplikacionet e TIK-ut si komunikimet mobile, lidhjet e internetit wireless (pa tela), videove me pagesë gjatë shikimit, kompjuterët personal, sistemet e navigacionit për vetura, etj., kanë ndryshuar rrënjësisht mënyrën se si individët punojnë dhe kënaqen në kohën e tyre të lirë dhe vazhdimisht ndryshojnë gjëra me shpejtësi dhe në mënyrë eksponenciale. Për pjesën më të madhe të Evropës dhe SHBA-së pa këto mjete dhe vegla, jeta është bërë e pa imagjinueshme.

Sidoqoftë, sipas Bordit për Standardizim të TIK-ut (tash e tutje BSTIK<sup>4</sup>) aplikacionet e cekura më lartë nuk do të arrijnë potencialin e tyre të plotë përderisa ato dhe infrastrukturat e tyre mbështetëse të mos jenë plotësisht ndërvepruese e kjo gjë është e mundur vetëm përmes standardeve. Standardet janë specifikacione teknike që mbështesin zhvillimin e tregjeve të hapura dhe konkurruese për të mirën e të dyja palëve: konsumuesve dhe industrisë, si dhe bashkëpunimi vullnetar për zhvillimin e specifikacioneve teknike i bazuar në konsensus në mes të palëve të interesuara quhet standardizim. Ky argument mund të fuqizohet edhe më tutje në mënyrën e rregullimit në Kosovë me faktin që standardizimi gjithashtu do të mundësonte një hyrje më të lehtë për kompanitë kosovare në tregun ndërkombëtar, duke ofruar dëshmi mbi standardet e cilësisë për klientët e mundshëm jashtë vendit. Një argument tjetër në favor të shkallës më të lartë të standardizimit në sektorin e TIK-ut që do të ndikonte pozitivisht në rezultatet e kontratave publike dhe të donatorëve në fushën e TIK-ut, ku kërkesat minimale të cilësisë do të rriteshin, e me këtë do të maksimizohesh vlera reale e investimit të qeverisë dhe donatorëve.

Nevoja për standardizim gjithashtu pranohet edhe nga kompanitë në sektorin e TIK-ut, të cilat investojnë shuma të rëndësishme të të hyrave të tyre për të trajnuar dhe ri-trajnuar punëtorët e tyre dhe për t'i pajisur ata me certifikata të njohura ndërkombëtarisht. Ngjashëm, udhëheqësit e tregut kanë marrë edhe një hap tjetër atë të certifikimit të kompanive të tyre me certifikata të cilësisë, të njohura ndërkombëtarisht.

### 2.1. Përfitimet nga standardizimi i TIK-ut

Përfitimet nga Standardizimi i TIK-ut shfaqen tek të gjithë të interesuarit e shoqërisë, si: individët, bizneset dhe administrata publike.

Individët përfitojnë nga standardizimi duke pasur në dispozicion zgjedhje shtesë dhe çmime më të ulëta, meqë standardet përdoren për të pasur në dispozicion qasje më të lehtë për më shumë se një zgjedhje të sistemit, pasi që cilësia më e lartë (dhe çmimet më të vogla) do të ofrohen si rezultat i konkurrencës së rritur në mes të prodhuesve dhe ofruesve të shërbimeve.

Bizneset do të përfitojnë nga besimi më i madh konsumuesve në produkte dhe shërbime të ndërmarrjeve që zbatojnë standardet e industrisë, nga shitjet më të mëdha meqë shërbimet fleksibile dhe ndër-operuese do të jenë më tërheqëse për klientët dhe nga ekonomia e asaj shkalle pasi që standardizimi do të ndihmojë sektorin e TIK-ut të mbërrij masën kritike më shpejtë dhe të arrij kompensimet mbi kostot e H&Zh-së (Hulumtimit dhe Zhvillimit- *angl.* R&D: Research and Development).

4 Bordi i Standardeve të TIK. <http://www.ictsb.org/index.htm>



Administrata publike përfiton nga standardizimi, pasi që standardet e TIK-ut janë thelbësore për zhvillimin e aplikacioneve ndër-operuese e që vet ato janë të rëndësishme për zhvillimin e ardhshëm ekonomik. Për më tepër, numri i kontratave jo-vepruese të TIK-ut të autorizuara nga institucionet publike do të zvogëlohej dukshëm përballë standardizimit më të madh.

Përfitimet nga standardizimi janë pranuar gjithashtu nga institucionet në nivel të BE-së, ku janë lëshuar një numër direktivash nga Komisioni Evropian për rregullimin e standardizimit të sektorit të TIK-ut. Autoritetet publike evropiane mbështesin fuqishëm standardet e hapura në TIK, sepse ato mund të ndikojnë që të sigurohet një konkurrencë e hapur në tregun elektronik dhe që të arrihen kërkesat bazike të një tregu të vetëm. Gjithashtu, standardet e TIK-ut ofrojnë një lloj matësi përmes së cilit mund të gjykohej ofertat për tenderët publik të prokurimit, e cila ndihmon edhe proceset edhe imazhin e transparencës brenda sektorit.

Në rrugën e saj të integritimit evropian, edhe Kosova duhet të krijojë një kornizë rregullative që është në përputhje me *“acquis communautaire”* dhe me sistemin e përgjithshëm të imponuar nga politikat e Tregut të Përbashkët. Për këtë qëllim, sa më herët që procesi të fillojë, ai do të ketë më pak efekte anësore në kompanitë kosovare pasi që do t'i jepte kompanive vendore më shumë kohë për t'u përgatitur për rregullat e Tregut të Brendshëm të BE-së.

Zhvillimi i Tregut Elektronik (e-tregut; angl. e-Commerce) është një tjetër përfitim që do të vinte si rezultat i standardizimit. Për këtë qëllim, institucionet publike duhet të investojnë më shumë kohë dhe përpjekje që ta kompletojnë infrastrukturën për e-tregun dhe për rregullat e lidhura me këtë degë të biznesit. Meqë ekziston një numër në rritje i kompanive që dëshirojnë dhe janë të etura për të zhvilluar biznesin tyre në platformën elektronike (e-platformën), krijuesit e politikave duhet t'u ofrojnë atyre kornizat rregullative për të bërë një gjë të tillë.

## 2.2. Vlerat dhe llojet e ndryshme të Certifikatave të TIK-ut

Nga Marrëveshja e dalë nga punëtoria (Certifikimi i TIK-ut në Evropë) e Komitetit Evropian për Standardizim (këtu e tutje KES) e vitit 2009, një certifikatë e TIK-ut apo (e-Certifikatë) mund të konsiderohet si një varg i proceseve nga të cilat një individ fiton një “kredencial” në një aftësi të caktuar të TIK-ut apo në mënyrë më të përgjithshme një diapazon aftësish. Kredenciale të tilla zakonisht jepen nga trupa të njohura (të pranuar), por jo përherë të akredituara nga ndonjë organizatë qeveritare apo zyrtare. Për të arritur kualifikimin, individit duhet të arrij një standard të deklaruar, të gjykuar nga një proces zyrtar i vlerësimit. E tërë skema drejtohet nga proceset e sigurimit të cilësisë, duke mbuluar zhvillimin dhe mirëmbajtjen e standardit të aftësive, por edhe procedurat e vlerësimit.

Sigurisht, përkufizimi më i saktë për nocionin e certifikimit në këtë kontest është ai i Dixon-it dhe Beier-it (CWA 15515, KES 2006):

*“Certifikim shpesh do të thotë dhënien e një certifikate, apo të një tjetër rekomandimi, që zyrtarisht njeh dhe regjistron suksesin në vlerësimin e Diturisë, Aftësive dhe/apo Njohurive, si një hap përfundimtar në kompletim të një Kualifikimi. Sidoqoftë, ai poashtu përdoret në lidhje të pjesshme me punët e Praktikuesit të TIK-ut, për të nënkuptuar Kualifikimin si të plotë. Ngritja e vetëdijes për këto dy kuptime të Certifikatës (“i ngushtë” dhe “i gjerë”) është tejet e rëndësishme.*

Vlerat e Certifikatave të TIK-ut prekin grupe të shumta të interesit:

- Për punëtorët apo kandidatët për punësim në të ofruarit e një matjeje të pavarur të vlerës së tyre (të ardhshme) për punëdhënësit, dhe me këtë i përmirësojnë gjasat e tyre për zgjedhje apo promovim, dhe me këtë edhe në përmirësim të pagës;
- Për punëdhënësit, duke ofruar një gjykim të jashtëm dhe një mjet të volitshëm i diferencimit të punonjësve potencial;

- Për nxënësit që janë duke iu nënshtruar trajnimit dhe për mësuesit e tyre, një nivel krahasues të kompetencave që duhet arritur;
- Për klientët e produkteve dhe shërbime të TI-së (Teknologjisë së Informacionit) një shkallë më të lartë të besimit në aftësitë e furnizuesve të tyre;
- Për furnizuesit e produkteve dhe shërbimeve të TI-së, një mjet promovues për të ndihmuar në rritjen e shitjeve apo për të arritur një çmim më të mirë;
- Për shitësit, një burim shtesë i të ardhurave dhe fitimeve, një aftësi e ekspertizës bazë në aplikimin e produkteve të tyre dhe një mbrojtje e kanalit shpërndarës të tyre (duke i kërkuar vet atij kanal që të marr certifikimet e tyre);
- Për shoqërinë, një shkallë e besimit në profesionalizmin e fuqisë punëtore të TIK-ut;

Ekzistojnë shumë lloje të certifikatave për TIK-un duke pasur këtë kategorizim themelor:

- Titujt dhe të tjera kualifikime arsimore kombëtare në TIK të ofruar nga universitetet dhe trupa të tjera akademike publike
- Anëtarësimi në trupave profesionale, shpesh herë me nivele të ndryshme, duke e lejuar përdorimin e përcaktimeve para- apo pas-nominale.
- Kualifikimet specifike të shitësve, zakonisht në vendosjen e vet produkteve të tyre, ku më e popullarizuara është Inxhinier i Certifikuar i Sistemeve të Microsoft-it (ICSM, angl. MCSE) dhe certifikata të tjera të Microsoft-it me mbi katër milionë sosh të lëshuara.
- Kualifikimet neutrale të shitësve, të cilat janë të ngjashme deri në një shkallë, p.sh. A-Plus e ofruar nga CompTIA, që është një asociacion i shitësve.
- Kualifikimet e pavarura të shitësve të ofruara nga organizatat tërësisht të pavarura të shitësve, me shembujt si në vijim:
  - Kualifikimet ISEB të ofruara nga BCS
  - Kualifikimet EUCIP të ofruara nga CEPIS dhe shoqatat anëtare të saj
  - Kualifikimet ISACA në qeverisjen përmes IT-së.

### 2.3. Pengesat dhe problemet e mundshme

Një nga sfidat më të mëdha për të paraqitur nivel më të lartë të standardizimit në sektorin e TIK-ut është kostoja relativisht e lartë e shumicës së certifikatave të njohura ndërkombëtarisht. Duke qenë fakti se shumica e kompanive në sektorin e TIK-ut janë mikro-ndërmarrje me deri në 20 punëtorë kostoja e certifikimit dhe standardizimit mund të jetë shumë e vështirë për t'u mbuluar. Përpos kësaj, për shkak të nivelit të pakënaqshëm të zbatimit të kontratave në Kosovë si dhe funksionimit të dobët të gjyqësorit në përgjithësi, do të ishte shumë e vështirë për kompanitë që të arrijnë t'i mbajnë punëtorët e tyre po që se ata certifikohen (në llogari ose shpenzime të kompanisë) dhe me këtë kthimi në investime për trajnime dhe ndërtim të kapaciteteve bëhet tejet i vështirë.

Për këtë qëllim, qeveria, shoqatat sektoriale (të tilla si STIKK-u) dhe agjencitë e donatorëve që e mbështesin zhvillimin në sektorin e TIK-ut duhet të investojnë në burime njerëzore dhe të zhvillojnë mjete që e bëjnë standardizimin më të lehtë për kompanitë që kalojnë nëpër atë proces. Gjithashtu, duhet të krijohen agjenci kombëtare për dhënie të standardizimeve dhe ashtu të kontribuojnë në uljen e kostonë së standardizimit për kompanitë e Kosovës.


Në mënyrë që rezistencat e mundshme nga ana e sektorit për të kaluar në standarde më të larta të trajtohen në mënyrën e duhur, qeveria duhet gjithashtu të ofrojë stimulime për kompanitë të cilat kalojnë nëpër standardizim. Stimulimet mund të vijnë në formë të lehtësimeve tatimore, subvencioneve për proceset e standardizimit apo në formë të kushtëzimit për pjesëmarrje në tenderë publik. Një qëndrim i tillë do të ishte një sinjal i qartë për sektorin sa i përket vendosmërisë për standardizim si orientim i politikave të institucioneve rregullative. Megjithatë, nëse rregullat e standardizimit adaptohen menjëherë dhe pa ndonjë përkrahje të duhur nga autoritetet publike, ajo gjë mund të prodhojë efekte të kundërta tek kompanitë më të vogla të këtij sektori, të cilat nuk do të ishin në gjendje t'u bëjnë ballë ngarkesave financiare të standardizimit.

### 2.4. Procesi i standardizimit dhe masat që duhet të merren

Skema nga e cila duhet shikuar si shembull në lidhje me procesin e standardizimit të TIK-ut për Kosovë, është ajo e përdorur në Certifikimin e TIK-ut në Projektin e Veprimit të nisur nga KES-i dhe Korniza Evropiane për e- njohuri. Certifikimi i TIK-ut në Veprim përcjell të dhënat për të prodhuar hartat e TIK-ut nëpër shtete, ku në disa prej të cilave paraqitet edhe përbërja e sektorit në treg dhe disa të tjera që prezantojnë udhërrëfyesin për standardizim në një shtet të caktuar. Në veçanti, Kosova duhet ta ndjek shembullin e Bullgarisë në këtë drejtim, pasi që praktikatat e mira nga ky shtet janë mjaft të përshtatshme për aplikim edhe në Kosovë.

Thënë shkurt, institucionet publike në Kosovë të përfshira në sektorin TIK-ut duhet të krijojnë shtesat e nevojshme të politikave për procesin e standardizimit të TIK-ut dhe për kërkesat e certifikimit në tenderët e TIK-ut për të ardhmen. Veç kësaj, Agjencia e Kosovës për Standardizim dhe Zyra Rregullative për Telekomunikacion duhet të kenë zyrat e vet për certifikim të trajnuar nga ekspertë të huaj të certifikimit në TIK. Shoqata e Kosovës për TIK (STIKK) do të duhej të përdorë rrjetin e vet për të ofruar bizneset pjesëmarrëse në procesin e standardizimit si dhe fonde të pjesshme (që dalin nga aplikuesit pjesëmarrës të certifikimit).

Certifikimi i TIK-ut në Veprim është pasardhës i marrëveshjes së dalë nga punëtoria e përmendur e KES-it dhe përdorë metodologjinë e kësaj të fundit kur bën nxjerrjen e hartave të shteteve të tyre. Një shembull i udhërrëfyesit të Certifikimit mund të shihet më poshtë:



Roli i STIKK-ut dhe i Qeverisë së Kosovës në standardizimin e sektorit të TIK-ut është kyç. Qeveria, siç u tha edhe më të lartë, do të luante rolin e inicimit në nxjerrjen e shtojcave të politikave të nevojshme (udhëzues administrativ dhe operativ si edhe në stimulimin e certifikimeve për kërkesat e sektorit të administratës publike) për sektorin e TIK-ut dhe në mirëmbajtjen dhe përshtatjen e atyre politikave në të ardhmen.

Ndërsa STIKK-u në anën tjetër, ka rolin e pikës qendrore të rrjetit të Kompanive të TIK-ut në Kosovë dhe poashtu do të mund të luante rolin e trupit certifikues të TIK-ut, në mënyrë që sektori TIK të jetë i vetë-qëndrueshëm përbrenda kontekstit të standardizimit. Kjo qasje do të ishte një zhvendosje drejt vet-rregullimit të sektorit, me çka roli i qeverisë do të reduktohej në një monitorim dhe vlerësim të thjeshtë të sektorit nga momenti kur STIKK-u merr për sipër procesin e standardizimit.

## 2.5. Integrimi në BE dhe Standardizimi në Fushën e TIK-ut

Respektimi i rregulloreve të BE-së në fushën e TIK-ut është faktor i domosdoshëm i procesit të përafrimit të legjislacionit të nevojshëm për hyrje në tregun e përbashkët. Disa prej hapave që duhen ndërmarrë janë të detyrueshëm në fazat para anëtarësimit të plotë (të tilla si marrëveshja e stabilizim-asocimit me BE-në). Përqaftimi i hershëm i këtyre politikave zvogëlon ndikimet negative që procese të tilla mund të kenë në ndërmarrjet e sektorit privat, sidomos në ndërmarrjet më të vogla. Të gjitha referimet dhe shembujt e dhënë më sipër janë pjesë e programeve dhe strategjive të sektorit të TIK-ut në BE, në shumicën prej të cilave janë të përfshira të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Në përpjekjet e Kosovës drejt integritimit në BE, fillimi i procesit të standardizimit bazuar në skemat e BE-së do të ishte një ndihmesë e rëndësishme pasi që respektimi i këtyre standardeve është i domosdoshëm. Fakti që sektori i TIK-ut në mbarë botën po bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar e bën të qartë nevojën për ndërmarrjen e masave sa më shpejt që të jetë e mundur.

## 3. PËRFUNDIMET E NXJERRA DHE REKOMANDIMET

Më poshtë jepen dhe argumentohen disa prej rekomandimeve për akterët e sektorit përkitazi me standardizimin në sektorin e TIK-ut.

### 3.1. Rekomandimet për qeverinë

**Organet qeveritare përgjegjëse për industrinë e TIK-ut duhet të përpilojnë një strategji dhe plan-pune për standardizim, si dhe të ndërmarrin menjëherë masa për realizimin e këtij plani.** Akterët duhet të përfshihen në këtë proces duke dhënë mendimet e veta rreth afateve dhe kriterëve të standardizimit.

**Të njoftohen në mënyrë të adekuate akterët rreth nevojës dhe vendimit për standardizim.** Nevojiten fushata informative rreth ndryshimeve të ardhshme në kornizën rregullative për operacionet e ndërmarrjeve të TIK-ut me qëllim që ndërmarrjet të përgatiten me kohë për ndryshimet e pritshme.

**Të formohen grupet punuese për të zhvilluar strategjinë dhe planin veprues për standardizim në sektorin e TIK-ut.** Ministria përgjegjëse duhet të mbledhë një ekip njerëzish prej institucioneve të përfshira, shoqatave të sektorit, si dhe përfaqësuesve të ndërmarrjeve të TIK-ut për ta përpiluar strategjinë, kriteret dhe plan-veprimin për standardizim.

**Të përgatiten akte ligjore dhe nënligjore për standardizim në sektorin e TIK-ut.** Kur strategjia të jetë përgatitur dhe të jetë caktuar afati kohor për planin e veprimit, ministria përkatëse duhet të fillojë përgatitjen e infrastrukturës ligjore për rregullimin e procesit të standardizimit.

**Të fillohet me ndërtimin e infrastrukturës për tregti elektronike.** Një prej komponentëve të rëndësishëm të standardizimit ka të bëjë me sistemin e pagesave elektronike brenda Kosovës, meqë për momentin nuk ka infrastrukturë të përshtatshme për afarizëm elektronik në Kosovë. Një infrastrukturë e tillë mund të nxitë zhvillimin e sektorit të TIK-ut, meqë do të hapte një pjesë shtesë tregu ku ndërmarrjet mund të ofronin shërbimet e tyre. Kjo do të ketë ndikim pozitiv në të gjithë sektorët meqë shërbimet dhe shitjet elektronike janë mundësi tërheqëse për një varg llojesh prodhimesh dhe shërbimesh.

**Të përpilohet skema e stimujve për standardizim.** Përveç subvencioneve për proceset e çertifikimit, qeveria gjithashtu mund të nxjerrë rregullore për t'i liruar nga taksat ndërmarrjet të cilat investojnë në standardizim. Në këtë mënyrë, ajo do ta bënte standardizimin më tërheqës për ndërmarrjet, si dhe do t'ua lehtësonte atyre barrën e drejtpërdrejtë.

### 3.2. Rekomandimet për STIKK-un

**STIKK-u duhet të themelojë një komitet/komision për standardizim të përkohshëm (apo të përhershëm).** Komiteti do të udhëheqë zhvillimin dhe shqyrtimin e politikave dhe rregulloreve mbi standardizimin. Komiteti (me miratimin e organeve më të larta të STIKK-ut) do të kishte rol këshillues, si dhe do të përfshihej në zhvillimin e politikave, do të merrte pjesë në grupet punuese me qeverinë, si dhe do të angazhohej brenda institucioneve legjislative për nxjerrjen e politikave të mira.

**Të fillojë procesin e standardizimit me ISO 9001.** Meqë STIKK-ut i takon të çojë përpara standardizimin në sektorin e TIK-ut, ajo duhet që fillimisht të kryejë vetë certifikimin e lartpërmendur, duke i dhënë kështu shembull të gjithë sektorit.

**Të vlerësojë certifikimet dhe standardizimet më të kërkuara dhe më të përshtatshme me përfaqësues të sektorit.** Shoqata duhet të këshillohet gjerësisht me ndërmarrje të TIK-ut dhe të përcaktojë qasjet më të përshtatshme për rregullimin e standardeve në sektor, duke ndihmuar kështu në nxjerrjen dhe rregullimin e politikave.

**Të shtojë mundësitë për t'u akredituar si qendër standardizimi/certifikimi për një apo më tepër certifikime ndërkombëtare.** Ky rekomandim bazohet në qasjen e përgjithshme të vetë-rregullimit të sektorit, si dhe e ndihmon qëndrueshmërinë financiare dhe institucionale të shoqatës.

**Të përfshihet në fushatën informative rreth rregulloreve të standardizimit dhe ndryshimeve të pritura me tregtizat e TIK-ut.** Pas zhvillimit të politikave përkatëse (strategjive, plan-veprimeve të standardizimit dhe dokumenteve të tjera që kanë të bëjnë me politikën), STIKK-u duhet t'i njoftojë ndërmarrjet rreth afateve të standardizimit dhe kushteve të përcaktuara në to.

### 3.3. Rekomandimet për bashkësinë e donatorëve

**Bashkësia e donatorëve në Kosovë (veçanërisht donatorët që veç e mbështetin sektorin e TIK-ut) duhet ta përkrahin STIKK-un dhe qeverinë duke i dhënë ndihmën teknike dhe përvojën e nevojshme gjatë zhvillimit të kornizës së standardizimit.** Investimet në këtë proces do të rritnin rolin e ndihmës së tanishme dhe të ardhshme të dhënë nga këta donatorë.

**Të mbështetet qeveria në përpilimin dhe financimin e skemës së stimujve.** Duke u përfshirë në procese të këtilla përmes një skeme grantesh apo me ofrimin e përvojës dhe ndihmës teknike, donatorët do të ndihmonin drejtpërdrejt zhvillimin e përgjithshëm të sektorit, si dhe ekonominë e përgjithshme.

**Të mbështetet STIKK në marrjen e akreditimit dhe certifikimit të nevojshëm për fusha të ndryshme të standardizimit.** Ndiurma financiare dhe teknike i nevojitet STIKK-ut për përmbushjen e hapave të nevojshëm për t'u akredituar si organ licencues/certifikues.

**Të investohet në ngritjen e vetëdijesimit të tek bizneset rreth rëndësisë dhe përfitimeve nga standardizimi.** Për të ulur rezistencën kundrejt ndryshimit, agjencitë donatore në bashkëpunim me qeverinë dhe STIKK-në duhet të përgatisin një platformë informative dhe vetëdijësuese që synon të informojë akterët e përfshirë ashtu siç duhet.

## REFERENCAT

Certifikimi për TIK në Evropë - Komiteti Evropian për Standardizim 2009.

<ftp://ftp.cenorm.be/CEN/Sectors/TCandWorkshops/Workshops/CWA16052.pdf>

Standardizimi në TIK - Bordi Evropian për Standarde në TIK. <http://www.icts.org/index.htm>

Standardizimi në TIK - Komisioni Evropian. <http://ec.europa.eu/enterprise/sectors/ict/standards/>

Certifikimi Veprues për TIK - Komiteti Evropian për Standardizim 2011.

[ftp://ftp.cen.eu/cen/Sectors/List/ICT/ICT\\_Cert\\_Draft\\_public%20comment.pdf](ftp://ftp.cen.eu/cen/Sectors/List/ICT/ICT_Cert_Draft_public%20comment.pdf)

Strategjia për të Drejtat e Pronësisë Intelektuale e Qeverisë së Kosovës 2010-2014.

[http://www.mti-ks.org/repository/docs/STRATEGY ON INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS\\_ eng.pdf](http://www.mti-ks.org/repository/docs/STRATEGY ON INTELLECTUAL PROPERTY RIGHTS_ eng.pdf)

Ligji nr. 2004/45 mbi të Drejtat e Autorësisë dhe të Drejta të Ngjashme - Gazeta zyrtare. <http://www.gazetazyrtare.com/e-gov/index.php?option=comcontent&task=view&id=62&Itemid=28>

Uebfaqja e Parlamentit të Kosovës. <http://www.kuvendikosoves.org>

Kushtrim Shaipi dhe Ardit Bejko. Programi për Ndërmarrje Private i Kosovës. TIK-u në Kosovë - Sektor i deshifruar. 2010. Mund të gjendet në:

<http://stikk-ks.org/en/publikimet-rreth-ict-tregut/demand-supply-survey.html>

Kushtrim Shaipi. Oda Amerikane e Tregtisë në Kosovë. Rëndësia e DPI-së për Bashkësinë Afariste në Kosovë. 2009.

# SHTOJCA 1: INFRASTRUKTURA LIGJORE PËR TË DREJTAT E PRONËSISË INTELEKTUALE

## 1.1. Ligjet

- Ligji nr. 2004/49 mbi Patentat i datës 27 shtator 2004, shpallur në bazë të Rregullores
- Ligji nr. 2004/56 i datës 21 dhjetor 2004, i përmirësuar me Ligjin nr. 02/L-100, shpallur me Rregulloren nr. 2007/10 të datës 6 shkurt 2007;
- Ligji nr. 02/L-45 mbi Dizajnët Industrialë i datës 21 nëntor 2005, shpallur me Rregulloren nr. 2006/17 të datës 21 prill 2006;
- Ligji nr. 02-L-54 mbi Markat Tregtare i datës 23 shkurt 2006, shpallur me Rregulloren nr. 2006/38 të datës 28 qershor 2006;
- Ligji nr. 2004/45 mbi të Drejtat e Autorësisë dhe të Drejta të Ngjashme, shpallur me Rregulloren nr. 2006/46 të datës 24 gusht 2006;
- Ligji nr. 02/L-98 mbi Mbrojtjen e Llojeve të Bimëve i datës 26 janar 2007, shpallur me Rregulloren nr. 2008/24 të datës 16 maj 2008;
- Ligji nr. 2009/03-L-170 mbi Masat Doganuese për Mbrojtjen e të Drejtave të Pronësisë Intellectuale, shpallur me Urdhrin e Presidentit DL-004-2010 të datës 8 janar 2010`.
- Projektligji mbi Topografinë e Qarqeve të Integruara ka kaluar me sukses procedurat qeveritare dhe i është paraqitur kuvendit për miratim.

## 1.2. Urdhëresat/Udhëzimet Administrative

- UA nr. 2007/10 mbi Procedurat e Regjistrimit të Patentave i datës 17 shtator 2007;
- UA nr. 2007/11 mbi Përfaqësimin në Fushën e të Drejtave të Pronësisë Industriale i datës 17 shtator 2007, përmirësuar në 2008-ën (UA-ja e përmirësuar nuk është edhe në anglisht);
- UA nr. 2007/12 mbi Procedurat e Regjistrimit të Dizajnëve Industrialë i datës 17 shtator 2007;
- UA nr. 2007/13 mbi Procedurat e Regjistrimit të Markave Tregtare i datës 17 shtator 2007; Kosova nën Rezolutën 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, raporti i progresit, Bruksel, 14 tetor 2009 / SEC (2009) 13409
- UA nr. 2007/14 i datës 19 shtator 2007 mbi zbatimin e rregullave që kanë të bëjnë me patentat, markat tregtare, dizajnët industriale, si dhe mbi lejet për markat tregtare dhe dizajnët industriale të dhëna para se të hynte në fuqi kjo UA;
- UA nr. 2007/19 mbi Tarifat e Mbledhura nga Zyra e Patentave e datës 5 tetor 2007.





Rr. Rexhep Mala, 28 A  
10000 Prishtinë, Republika e Kosovës  
Tel. +386 43 767 076, Fax. +381 38 234 443,  
info@stikk-ks.org, [www.stikk-ks.org](http://www.stikk-ks.org)

PËRKRAHUR NGA:

